



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Regj. Them. 13212/7744/3413 (31023-01295-86-2017)

Nr. Vendimit 1457

Data e regjistrimit 16.03.2017

Data e vendimit 13.05.2019

VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

<b>Lindita SINANAJ</b>	<b>KRYESUESE</b>
<b>Amarildo LAÇI</b>	<b>ANËTAR</b>
<b>Bari SHYTI</b>	<b>ANËTAR</b>

me sekretare gjyqësore [REDAKTUAR] në Tiranë, sot më datë 13.05.2019, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative, që i përket palëve:

**PADITËSE:** [REDAKTUAR] e bija e [REDAKTUAR] në datëlindjes [REDAKTUAR] lindur e banuese në Berat.

**TË PADITUR:** *-Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.*  
*-Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Berat.*

**PALA E TRETË:** *Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Tiranë.*

**OBJEKTI:** I. Konstatimi i faktit të diskriminimit të drejtpërdrejtë ndaj paditëses, e kryer nga ana e palëve të paditura, Fondi i Sigurimit të

Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Berat.

2. Detyrimin e palëve të paditura, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Berat të dëmshpërblejë paditësen për dëmin pasuror dhe jopasuror të pësuar.

3. Detyrimin e palëve të paditura, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Berat të paguajë shpenzimet gjyqësore dhe ato të përfaqësimit me avokat.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 17/2, 18, 33/1, 42, 44, e 49 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 14 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 31, 32/a, 153, 154 të K.Pr.Civile; nenet 9, 10, 10/1 të K.Punës; nenet 3, 7, 12, 13, 34, 36, 37, 38 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”; nenet 608, 609, 625, 640 të Kodit Civil; Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 12, datë 14.09.2007; Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 17.02.2012.

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr. 1890, datë 17.11.2016, ka vendosur:**

- Rrëzimin e padisë.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga e nesërmeja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, afat i cili për palën në mungesë fillon nga dita e nesërme e marrjes dijeni mbi këtë vendim.

**Kundër vendimit nr. 1890, datë 17.11.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ka paraqitur ankim paditësja [REDAKTUAR], që kërkon ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesëpadisë, duke parashtruar këto shkaqe:**

- Vendimi i gjykatës është tërësisht i padrejtë i pabazuar në ligj dhe në prova dhe si i tillë duhet të ndryshohet duke u pranuar kërkesëpadia.
- Në këtë gjykim me objekt detyrim i rrjedhur nga shkaktimi i dëmit, paditësi kërkon dëmshpërblimin “për të gjitha dëmet” apo “për të gjitha dëmet pasurore e jopasurore” dhe kjo mënyrë kërkimi ishte në disponimin e tij për kërkimin e dëmshpërblimit për çdo figurë të dëmit pasuror e jopasuror. Padia përmbante kërkime për dëmshpërblimin e figurave konkrete të dëmit jashtëkontraktor.
- Në rastin e dëmtimit të shëndetit të paditësit nga fakti i paligjshëm, sikurse ka ndodhur në çështjen objekt i këtij gjykimi, ai si paditës ka pësuar dëm dhe ka legjitimim aktiv për kërkimin e shpërblimit të dëmit pasuror e jopasuror të pësuar.
- Paditësi pretendon se nga veprimet e kundërligjshme të punëdhënësit ka pësuar çënime të rënda të shëndetit e personalitetit të saj, në marrëdhëniet dhe interesat familjare, si në aspektin pasuror dhe atë jopasuror. Ajo kërkonte rikthimin e saj në gjendjen e mëparshme, sikur ky fakt i paligjshëm të mos kishte ndodhur, duke u detyruar i padituri t’i dëmshpërblente humbjet pasurore nga pakësimi i të ardhurave në familje, si dhe dëmet e tjera jopasurore shëndetësore për vuajtjen shpirtërore, çënimin e vlerave e të cilësisë së jetës familjare, personale e private të tyre. Neni 608 i K.Civil parashikon edhe dëmshpërblimin për dëmet jashtëkontraktore të pësuar nga vetë i dëmtuari në personin ose dhe pasurinë e tij”.
- Fakti i paligjshëm, solli si pasojë pakësimin e marrëdhënieve prindërore familjare me paditësen, si rrjedhojë edhe çënimin e interesave të ligjshme jopasurore që lidhen me personalitetin e tyre, si cilësia e jetës, paprekshmëria e familjes, solidariteti reciprok, dhimbja e vuajtja shpirtërore e tyre, etj.
- Dëmi pasuror si figurë e dëmit jashtëkontraktor civil ka sjellë si pasojë edhe çënimin e pasurisë së tij si paditës, i dëmtuar, në kuptimin e ngushtë ekonomik, pasi i është shkaktuar humbja e pasurisë (deminutio patrimonii) në mënyrë të paligjshme. Prandaj edhe shpërblimi i dëmit pasuror kishte për qëllim të rikthente pasurinë e tij si i dëmtuar

në gjendjen e mëparshme, duke “mbushur” diferencën e krijuar ndërmjet gjendjes ekonomike aktuale të tij me atë në të cilin do të ndodhej nëse nuk vërtetohej fakti i paligjshëm.

- Dëmi biologjik, i njohur në teori si dëmtimi i shëndetit, përbën në thelb cënimin e shëndetit dhe integritetit fizik e psikik të njeriut. Ky dëm përbënte objekt kërkimi të pavarur nga dëmi pasuror e llojet e tjera të dëmit jopasuror dhe masa e dëmshpërblimit duhet t’i përafrohet shkallës konkrete të cënimit të përhershëm ose të përkohshëm të integritetit fizik ose psikik të të dëmtuarit. Në këtë kuptim, neni 625 i K.Civil bënte dallimin ndërmjet dy grupeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që nuk kanë natyrë pasurore të mbrojtura prej saj në rast cënimi.
- Dëmtimi i shëndetit të paditësit ka ardhur si pasojë e cënimit të integritetit fizik dhe/ose psikik prej veprimeve të padrejta të punëdhënësit. Të drejtat e njeriut për jetën dhe shëndetin janë të drejta objektive që lindin dhe janë të padhunueshme e të pandashme me vetë ekzistencën e tij. Prandaj si të tilla ato mbrohen e garantohen si të drejta themelore të njeriut nga Kushtetuta (neni 3,15/1 dhe 21 i saj). Mbrojtja e shëndetit të njeriut mëshirohet jo vetëm në detyrimin e shtetit për kujdesin shëndetësor, por edhe në të drejtën për të realizuar këtë mbrojtje në gjykatë, ndërmjet të tjerave, duke detyruar cilindo që cënonte integritetin e tij fizik e psikik të dëmshpërblejë dëmin e shkaktuar.
- Dëmtimi i shëndetit (dëmi biologjik) përbën, në thelb, cënimin e së mirës, së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut. Ky dëm jopasuror, i parashikuar nga shkronja “a” e nenit 625 të Kodit Civil, është objekt kërkimi dhe dëmshpërblimi i pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësuar nga i dëmtuari për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm. Meqenëse jeta dhe shëndeti i njeriut nuk ka çmim, në respektim të parimit themeltar kushtetues të barazisë përpara ligjit dhe ndalimit të diskriminimit, sipas nenit 18 të Kushtetutës, gjykata duhet të garantonte një gjykim uniform dhe vlerësim të njëjtë të përqindjes e të masës së dëmshpërblimit të dëmit biologjik, për çdo formë e shkallë konkrete të cënimit të përhershëm a të përkohshëm të integritetit fizik ose psikik të të dëmtuarit.
- Dëmi biologjik, duke qenë cënim në integritetin fizik dhe/ose psikik të njeriut, ishte objektivisht i vërtetueshëm. Prandaj, në zbatim të rregullave parimore të neneve 2, 6, 29 e

vijues të K.Pr.Civile, paditësja si e dëmtuar kërkon dëmshpërblimin duke përdorur në gjykim me akt ekspertimi nëpërmjet ekspertit vlerësues dhe psikolog dëmin që ka pësuar, si dhe lidhjen shkakësore të tij me faktin e paligjshëm.

- Dëmi moral është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e pasigurisë e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm. Cilido që pëson çënime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti ka të drejtën të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit moral të pësuar.
- Dëm ekzistencial, i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të paditurit çënonte të drejtat e personalitetit të paditësit, duke i dëmtuar në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e tij si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke i tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtaritë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqësim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare.
- Dëmi moral ashtu edhe sikur dëmi ekzistencial kishin natyrë subjektive, prandaj shuma e dëmshpërblimit të saj duhej të caktohej në mënyrë të pavarur nga dëmi moral, por duke zbatuar të njëjtat kritere dhe metoda të vlefshme për llogaritjen e dëmshpërblimit të këtij të fundit.
- Për të vërtetuar lidhjen shkakësore dhe masën e dëmit të pësuar në vlerë reale u vërtetua në gjykim nëpërmjet akteve të ekspertimit.
- Ekspertimi psikologjik i cili doli në përfundim se, paditësja për shkak të transferimit dhe shkarkimit nga puna, prej të paditurve me bazë diskriminimi ka kaluar në një situatë e ndryshme psikologjike, e cila ka ndikuar në jetën e saj në ndryshimin e funksioneve efektive, planet dhe objektivat duke çënuar ekuilibrin psikologjik, në formën e çënimit të personalitetit dhe potencialit të vet njerëzor, kjo për shkak të prezencës së simptomave të depresionit dhe çrregullimeve të ankthit që janë zhvilluar kohën pas shkarkimit nga puna. Gjendja e saj e ndikuar nga simptoma të çrregullimeve të konstatuara ka kompromentuar realizmin e potencialit të vet njerëzor dhe profesional, e kjo veç ndikimit të deritanishëm mund të ketë ndikim edhe në të ardhmen deri në zhdukjen e simptomave të shfaqura.

- Ekspertimi mjekësor vërtetoi se te paditësja [REDAKTUAR], vihen re këto dëmtime shëndetësore: Neuroze situacionale me element depresiv. Strume nodulare, gradë e parë, për paditësen [REDAKTUAR] kemi humbjen e aftësisë për punë në masën 10% nga gjendja e krijuar.

### ***GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT***

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtares Lindita Sinanaj, shqyrtoi aktet e dosjes dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N**

#### **1. Rrethanat e çështjes.**

Paditësja [REDAKTUAR] ka punuar në DRFSKSH-në Berat, prej 15 vitesh, në pozicione të ndryshme pune. Marrëdhëniet e punës në këtë institucion kanë nisur në vitin 1999 dhe kanë vazhduar pa ndërprerje, deri më datë 31.01.2014. Nga viti 1999 deri në vitin 2002, ka punuar si ekonomiste pranë DRSKSH-së Berat, për periudhën 2002-2006 ka punuar si shefe e sektorit të statistikës, për periudhën 2006 - tetor 2013 si zv.drejtoresh dhe nga muaji nëntor 2013-janar 2014 specialiste pranë sektorit spitalor. Me urdhërin nr. 189, datë 23.10.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH-së, është liruar nga detyra e zv/drejtoresh dhe e ka emëruar si specialiste ekonomiste në sektorin spitalor në DRSKSH-në, Berat. Paditësja ka punuar në këtë pozicion pune deri më datë 31.01.2014, kur me urdhrin nr. 1, datë 31.01.2014, të Drejtorit të këtij institucioni, i është zgjidhur në mënyrë të njëanshme dhe të menjëhershme kontratën e punës.

Paditësja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesëpadi me objekt "Detyrimin e palës së paditur DRSKSH Berat, për dëmshpërblim për zgjidhje të marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme, në mungesë të respektimit të procedurës, afatit dhe të mospagesës për vjetërsi në punë". Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin me nr. 464, datë 08.04.2014, ka vendosur pranimi i padisë

dhe detyrimin e Drejtorisë Rajonale të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor ti paguajë paditëses 8 paga mujore si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëherëshme e të pajustificuar të kontratës së punës, 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurës në zgjidhjen e kontratës së punës. 3 paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit dhe 7 paga mujore si shpërblim për vjetërsinë në punë. Ky vendim, pas ankimit prej palës së paditur është marrë në shqyrtim nga Gjykata Administrative e Apelit e cila me vendimin nr. 1026, datë 18.05.2015 ka vendosur ndryshimin e pjesëshëm të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë në lidhje me njohjen e dëmshpërblimit prej dy muaj page për mosrespektim të procedurës për këtë zgjidhje kontrate pune, duke vendosur rrëzimin e padisë në lidhje me këtë kërkim të paditëses, dhe lënien në fuqi të vendimit lidhur me disponimet e tjera.

Paditësja Nevila Hyska, duke pretenduar se kundrejt saj, qenia pjesë e listës emërore të kandidatëve për deputet të Partisë Demokratike për Qarkun e Beratit, në zgjedhjet e vitit 2013, ka ndikuar në pushimin nga puna që mbante në DRSKSH-në Berat, i është drejtuar me ankesë pranë KMD Tiranë (Komisionieri për Mbrojtjen nga Diskriminimi), duke parashtruar si argumente se ndryshimi i strukturës së DRSKSH-së Berat, në të dy rastet kur në të janë bërë shkurtime përkatëse, ndryshimet kanë prekur vetëm pozicionet e punës që ka mbajtur paditësja. Gjithashtu, referuar provave të vëna në dispozicion nga ana e FSDKSH-së, konstatohet se shkurtime të pozicionit të punës të zv. Drejtorit të Drejtorive Rajonale ka patur vetëm DRSKSH Berat dhe asnjë drejtori tjetër e rretheve.

Mbështetur në strukturën e DRSKSH-së Berat, rezulton se Sektori i Shërbimit Spitalor, në momentin që ankuesja u emërua në pozicionin e specialistes ekonomiste, përbëhej nga Përgjegjësi i Sektorit, i cili duhej të kishte profesionin mjek ose ekonomist dhe dy specialist, njëri mjek dhe tjetri ekonomist. Në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit ishte i emëruar z. Ildir Frashëri, me profesion mjek, ndërsa në pozicionin e specialistëve ishte emëruar znj. Kamela Toska dhe paditësja Nevila Hyska, të dyja me profesion ekonomiste. Në Kapitullin 3.3, pika II “Ngritja në detyrë, lëvizja paralele dhe transferimi”, të Rregullores së Personelit të FSDKSH-së, për Drejtorinë Rajonale, parashikohet: “Vendet e lira mund të zihen nga punonjësit ekzistues, kur plotësojnë kriteret e përcaktuara nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, transferimit (kur ka

kërkesë nga ana e punonjësit) dhe ngritjes në detyrë. Për D. Rajonale lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë është kompetencë e drejtorit të D. Rajonale, ndërsa transferimi bëhet me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm.”

Me largimin e z. Ildir Frashëri nga pozicioni i Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimit Spitalor, Drejtori i DRSKSH-së Berat ka emëruar në këtë pozicion punë znj. [REDAKTUAR], duke qenë se ishte pjesë e këtij sektori. Në kapitullin e II të Rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e punës për Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, në të cilin përshkruhen kualifikimet, aftësitë dhe eksperiencia e punës, parashikohet se Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Spitalor, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë ekonomi/mjekësi.
- Eksperiencë pune mbi 5 vjet.
- Aftësi komunikuese dhe pune në grup.
- Njohuri bazë në kompjuter.

Referuar dosjes personale të punës së znj. [REDAKTUAR] vihet re se është punësuar për herë të parë, pranë DRSKSH-së Berat, në Sektorin e Shërbimit Spitalor, në pozicionin e specialistes ekonomiste, më datë 01.06.2009. Mbështetur në kontratën nr. 593/2 prot., datë 10.12.2013, znj. Toska është emëruar në pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit të Shërbimit Spitalor. Përse më lart dhe në mbështetje të Rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e punës për Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, konstatohet se znj. [REDAKTUAR] nuk ka plotësuar njërin prej kriterëve të parashikuara në rregullore, atë të eksperiencës në punë mbi 5 vjet, pasi rezulton që ajo të ketë 4 vite eksperiencë pune. DRSKSH Berat, edhe pse kishte si alternativ zgjedhje, znj. [REDAKTUAR] për ta emëruar në pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit të Shërbimit Spitalor, duke qenë se plotësonte të gjitha kriteret e kërkuara në Rregulloren “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e punës për Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, ka emëruar znj. [REDAKTUAR] e cila nuk plotësonte kriteret për të mbajtur këtë pozicion pune.



Lidhur me situatën e disfavourshme dhe të pabarabartë duke u transferuar fillimisht dhe më pas duke u pushuar në mënyrë të kundërligjshme, KMD Tiranë është shprehur me anë të vendimit me nr. 119, datë 31.07.2015 ku ndër të tjera Komisioni ka vendosur: “Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë për shkak të bindjeve politike të ankueses znj. [REDAKTUAR] e kryer nga ana e Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Berat. Detyrimin e punëdhënësit ta rikthejë në vendin e mëparshëm të punës.” Në rrethana të tilla paditësja [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi, duke kërkuar konstatimin e faktit të diskriminimit të drejtpërdrejtë ndaj paditësit, e kryer nga ana e palëve të paditura, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Berat dhe detyrimin e palëve të paditura, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, Berat, të dëmshpërblejnë paditësen për dëmin pasuror dhe jopasuror të pësuar.

## **2. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.**

Në vlerësim të pretendimeve të parashtruara, të provave e akteve shkresore të administruara dhe rrethanave të faktit e të ligjit, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se paditësja [REDAKTUAR] ka punuar në DRFSKSH-në Berat, prej 15 vitesh, në pozicione të ndryshme pune, deri kur me urdhërin nr. 1, datë 31.01.2014, të titullarit të këtij institucioni, i është zgjidhur në mënyrë të njëanshme dhe të menjëhershme kontratën e punës. Në rrethana të tilla pala paditëse i është drejtuar gjykatës administrative me kërkesëpadi për zgjidhjen e konfliktit të punës me palën e paditur.

Pretendimi i parashtruar në padi nga ana e paditëses se zgjidha e kontratës së punës së saj prej palës së paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor Berat, është bërë e kundërligjshme, pa asnjë motiv dhe pa shkak të arsyeshme dhe në mungesë të plotë të respektimit të afatit të kësaj zgjidhje kontrate pune, është një fakt tashmë i provuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe produkt i vërtetimit të këtij fakti është njohja e së drejtës së saj për t’u kompensuar për dëmin e shkaktuar nga kjo zgjidhje kontrate punësimi, e drejtë e paditëses e cila gjen mbështetjen ligjore në dispozitat e Kodit të Punës. Pikërisht, dispozitat e

këtij Kodi parashikojnë të drejtat që i njihen paditëses në rastin e vërtetimit të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës në kundërshtim me ligjin, ku është parashikuar edhe në rastin e vërtetimit të faktit se zgjidhja e kontratës së punës të jetë kryer në kushtet e ekzistencës së rrethanave të parashikuara në nenin 146 të Kodit të Punës, pra ku zgjidhja është bërë pa shkaqe të arsyeshme. Pra, edhe në rastet kur provohet se zgjidhja e kontratës së punës prej punëdhënësit është bërë edhe për raste kur nuk kemi të bëjmë me raportet e punës, sikurse provohet në rastin konkret se është bërë për shkak të bindjeve politike të paditëses, është parashikuar se e vetmja formë e dëmshpërblimit është detyrimi i punëdhënësit t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit.

Paditësja [REDAKTUAR] duke iu referuar këtij fakti, si edhe përmbajtjes së neneve 608, 609, 625 dhe 640 të K.Civil, kërkon detyrimin e të paditurit që t'i paguajë dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar. Gjykata, referuar kërkesës së palës paditëse për thirrjen në dobi të këtij gjykimi dhe ekspert nga fusha e psikologjisë dhe e vlerësimit të dëmeve shëndetësore, pranoi kërkesën e saj si pjesë e domosdoshme e një hetimi gjyqësor me kërkime të tilla dhe në mungesë të paragjyqimit në lidhje me zgjidhjen e kësaj çështje, si pjesë e një procesi të rregullt gjyqësor, në mbështetje të neneve 224/a të K.Pr.Civile, caktoi dy ekspertë, të cilët dhanë vlerësimin e tyre dhe pasi ju dha mundësi palëve të parashitrojnë pretendimet e tyre në lidhje me këto akte dhe në vlerësimin total të të gjithë provave arriti në konkluzionin përfundimtar të pasqyruar në vendimmarrje.

Gjykata çmon se ky pretendim i paditëses [REDAKTUAR] është i pambështetur në ligj dhe nuk duhet të pranohet. Nenet 608 e vijues të K.Civil trajtojnë përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit në marrëdhëniet jashtëkontraktore. Dallimi kryesor midis dëmit kontraktor dhe atij jashtëkontraktor qëndron në faktin se dëmi kontraktor lind për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore, ndërkohë që dëmi jashtëkontraktor vjen si rezultat i një sjelljeje të ndaluar nga ligji. Ky i fundit lind në mungesë të kontratës apo nuk ka të bëjë fare me kontratën. Në bazë të dëmit jashtëkontraktor qëndron ai fakt, i cili përbën shkakun e një dëmi pasuror ose jopasuror. Ky fakt mund të jetë çdo sjellje e njeriut, ngjarje shoqërore apo fenomen i natyrës, të cilës ligji i ngarkon një pasojë juridike.

Kodi Civil rregullon në mënyrë të shprehur, të qartë dhe të ndarë dëmin kontraktor dhe dëmin jashtëkontraktor, duke u njohur njëkohësisht të drejtën personave që të kompensohen për dëmet që mund t'u jenë shkaktuar si rezultat i shkeljes së kontratës apo kryerjes së ndonjë veprimi të paligjshëm. Gjykata, duke iu referuar kësaj analize, vlerëson se qëndrimi i paditëses është kontradiktor në këtë drejtim, pasi, nga njëra anë pretendon se dëmi pasuror dhe jopasuror i është shkaktuar nga zgjidhja e kontratës së punës (*qoftë edhe për shkak të bindjeve të saj politike*) dhe nga ana tjetër, ajo i është referuar neneve 608 e vijues të K.Civil, të cilat rregullojnë përgjegjësinë që lind për shpërblimin e dëmit në marrëdhëniet jashtëkontraktore.

Palët ndërgjyqëse kanë qenë të lidhura në një marrëdhënie kontraktore me njëra-tjetrën, sikurse është kontrata e punës. Kontrata e punës e lidhur mes palëve ndërgjyqëse ka parashikuar, përveç të tjerave, edhe rastet e zgjidhjes së saj, si një nga veprimet juridike dhe aspektet më të rëndësishme të saj. Në këtë kontratë janë parashikuar veprimet e palës tjetër kontraktore që mund të përbëjnë shkak për zgjidhjen e kontratës së punës. Nga ana tjetër, Kodi i Punës ka parashikuar në mënyrë të qartë dhe të plotë përgjegjësitë që lindin për punëmarrësin dhe punëdhënësin në rastin e mospërbushjes së detyrimeve kontraktore, veçanërisht në rastin e zgjidhjes së kontratës së punës. Nenet 144/5, 145, 155/1 dhe 155/3 të K.Punës kanë parashikuar përgjegjësinë që lind për punëdhënësin për shpërblimin e dëmit që i shkaktohet punëmarrësit në rastin e zgjidhjes së kontratës së punës në kundërshtim me ligjin.

Nga hetimi gjyqësor i kësaj çështjeje, ka rezultuar i provuar fakti se paditësja [REDAKTUAR] i ka fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë të gjitha të drejtat (dëmshpërblimet përkatëse) që i takojnë për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës nga e paditura Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor Berat. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, në vendimin me nr. 464, datë 08.04.2014 ka arritur në përfundimin se zgjidhja e kontratës së punës së paditëses ka qenë e menjëhershme dhe e pajustificuar dhe ka vendosur detyrimin e të paditurit që t'i paguajë dëmshpërblimet përkatëse. Në rastin konkret, përgjegjësia e të paditurit, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor Berat, është një përgjegjësi që lind nga kontrata e punës që ka lidhur me paditësen [REDAKTUAR] përderisa edhe ky i fundit ka pretenduar se dëmi i është shkaktuar si rezultat i zgjidhjes së kësaj kontrate.

Paditësja Nevila Hyska e ka fituar me vendim gjyqësor të drejtën e saj për t'u dëmshpërblyer për zgjidhjen e padrejtë të kontratës së punës nga e paditura Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor–Berat. Dëmi që i është shkaktuar paditëses ka ardhur si rezultat i zgjidhjes së padrejtë të kontratës së punës nga i padituri, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka kryer asnjë veprim tjetër që nuk ka lidhje me kontratën e punës dhe që t'i ketë shkaktuar paditëses një dëm të ndryshëm nga ai kontraktor. Nga interpretimi literal dhe gramatik i nenit 420 të Kodit Civil, gjykata arrin në përfundimin se, detyrimet ose marrëdhënia juridike e detyrimit midis personave fizike ose juridike apo midis një personi fizik dhe një personi juridik, lind së pari, nga kontrata dhe së dyti nga ligji. Nëse në rastin e parë, është pikërisht kontrata, e cila përfaqëson një veprim juridik të dyanshëm, e cila shërben si fakt juridik për lindjen e marrëdhënies juridike të detyrimit, në rastin e dytë është ligji apo norma juridike, ajo e cila shërben si shkak për lindjen e kësaj marrëdhënie. Rastet kur, marrëdhënia juridike e detyrimit buron nga ligji, janë atëherë kur, ndodhemi përpara begatimit pa shkak apo përfitimit pasuror pa të drejtë (pa titull), si dhe rasti kur ndodhemi përpara institutit juridiko-civil të shkakimit të dëmit jashtëkontraktor, i cili gjen pasqyrim tekstual në nenet 608 e vijues të Kodit Civil.

E përbashkëta e të gjitha formave të sipërcituara të dëmit jashtëkontraktor, konsiston në faktin se, që personi fizik apo juridik, i cili pretendon se i është shkaktuar një dëm jashtëkontraktor (pasuror, jopasuror, biologjik, ekzistencial), të legjitimohet aktivisht në ngritjen e padisë së shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor, duhet të provojë përpara gjykatës plotësimin në mënyrë kumulative, të këtyre katër elementëve: karakterin e paligjshëm të veprimit apo mosveprimit, ekzistencën e dëmit, lidhjen shkakësore midis veprimit apo mosveprimit dhe pasojës së ardhur, ekzistencën e fajit (dashja, pakujdesi e rëndë apo e lehtë), në lidhje me kryerjen e veprimit apo moskryerjen e mosveprimit. Duke u nisur nga cilësitë juridike të subjektit, i cili ka shkaktuar dëmin jashtëkontraktor, dhe pikërisht rastin kur, dëmi shkaktohet nga një organ i administratës shtetërore, Kushtetuta në nenin 44 ka parashikuar të drejtën që ka titullari i së drejtës së shkelur nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të organeve shtetërore, të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin sa i takon dëmit të shkaktuar.

Në rastin konkret, në kushtet kur pala e paditur e thirrur në këtë proces, konform nenit 1 të K.Pr.Administrative, ajo do t'i nënshtrohet të gjitha parimeve të përgjithshme të së drejtës publike dhe civile, nëse ligji e parashikon këtë mundësi. Duke u ndodhur përpara rezervës ligjore absolute, pikërisht kjo e drejtë kushtetuese, zbërthehet dhe gjen pasqyrim në Ligjin Nr. 8510, datë 19.7.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore", i cili nga ana e tij referon tek dispozitat e Kodit Civil, që rregullojnë institutin material të shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor. Nga interpretimi sistematik dhe teologjik i neneve 1, 3, 10 dhe 14 të ligjit, në harmoni me nenet 608 e vijues të Kodit Civil, gjykata arrin në përfundimin se, në të gjitha ato raste kur, një apo disa organe të administratës shtetërore, gjatë përmbushjes ose jo të detyrave apo funksioneve të tyre, në përputhje ose jo me ligjin, me anë të veprimeve apo mosveprimeve konkrete, u shkaktojnë dëm pasuror ose jopasuror në interesat e tyre të ligjshëm personave fizike ose juridike, vendas apo të huaj, do të mbajnë përgjegjësi individuale apo solidarë për shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor, pasuror ose jopasuror, duke përfshirë këtu edhe fitimin e munguar.

Për sa më sipër, gjykata, në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes civile objekt gjykimi, me qëllim realizimin e një cilësimi të saktë juridik të fakteve objekt gjykimi, në harmoni edhe me provat e administruara në seancë gjyqësore, çmon të marrë në analizë veçmas, secilin prej katër elementëve të sipërcituar, plotësimi bashkarisht, i të cilëve passjell si pasojë legjitimitimin e paditëses në ngritjen e padisë së shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor. Gjykata çmon se, kuptimi i paligjshmërisë së veprimit apo mosveprimit, i parashikuar nga neni 608 i Kodit Civil, i referohet jo vetëm rastit kur një veprim apo mosveprim vjen në kundërshtim me ligjin, por edhe në rastin kur, ai vjen në kundërshtim me Kushtetutën, një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar me ligj, një vendim gjyqësor, i cili sanksionon një të drejtë apo interes të ligjshëm, apo vjen në kundërshtim me parimet e përgjithshme të gjithëpranuara të së drejtës. Karakteri i paligjshmërisë së veprimit apo mosveprimit nënkupton, faktin e kryerjes së një veprimi (gjendje aktive) apo moskryerjes së një veprimi (gjendje pasive), i cili objektivisht vjen në kundërshtim me parashikimet dhe rregullimet ligjore përkatëse, të cilat mund të kenë karakter ndalues, detyrues apo lejues, dhe të cilat synojnë që sjelljet e personit fizik apo juridik t'i nënshtrohen këtyre parashikimeve apo rregullimeve ligjore. Për sa më sipër, duke i ballafaquar faktet objekt

gjykimi, me provat e administruara, me parashikimet kushtetuese dhe ligjore, gjykata çmon se, nuk kemi veprim të palës së paditur të cilat përbëjnë paligjshmëri në kundërshtim me parimin e përgjegjshmërisë, në kuptim të parashikimit të nenit 608 të Kodit Civil dhe neneve 1 dhe 14 të K.Pr.Administrative.

Elementi i dytë i institutit juridiko-civil të shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor, është ai i vetë nocionit të dëmit, i cili sipas doktrinës të së drejtës civile, përfaqëson pasojën e ardhur, si rezultat i veprime apo mosveprimeve të paligjshme. Kjo do të thotë se, veprimet apo mosveprimet e subjektit, person fizik apo juridik, janë të karakterit material, të cilat kërkojnë domosdoshmërisht ardhjen e një pasoje, e cila konsiston në uljen e integritetit ekonomik të titullarit të së drejtës subjektive të cënuar. Përveç sa më sipër, dëmi duhet të përbëjë pasojën e drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme të veprimit apo mosveprimit konkret, fakt i cili nuk rezultoi i provuar nga pretendimet e palës paditëse në këtë gjykim.

Sa i takon lidhjes shkakësore, përveç faktit se sipas, nenit 609 të Kodit Civil, dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit, në asnjë dispozitë të Kodit Civil, nuk jepet një përkufizim apo definicion në lidhje me të, por gjykata mban parasysh, përkufizimin që teoria e së drejtës penale dhe Kodi Penal (neni 13) jep për lidhjen shkakësore, duke e konsideruar si, lidhjen e drejtpërdrejtë dhe determinante që duhet të ekzistojë midis veprimit apo mosveprimit, pasojës së ardhur apo mundësisë së ardhjes së saj. Kjo do të thotë, se midis pasojës së ardhur dhe veprimit apo mosveprimit, duhet të ketë lidhje shkakësore, në kuptimin që, pasoja e ardhur vjen ekskluzivisht si rezultat i veprimit apo mosveprimit, që do të thotë se, mungesa e veprimit apo mosveprimit të paligjshëm, nuk do të passillte ardhjen e pasojës përkatëse.

Në çështjen objekt gjykimi, gjykata çmon se dëmi pasuror dhe jopasuror, i pretenduar i shkaktuar ndaj palës paditëse, për të cilin gjykata u shpreh si më sipër nuk është rrjedhojë, e drejtpërdrejtë dhe e menjëhershme e veprimeve të palës së paditur. Parë nga ky këndvështrim, gjykata çmon se, midis pasojës së ardhur, dëmit të pretenduar ndaj palës paditëse, dhe veprimeve apo

mosveprimeve të palës së paditur, nuk ekziston lidhja shkakësore, në kuptimin që, dëmi i ardhur vjen direkt dhe ekskluzivisht si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve përkatëse.

Fajësia, lidhet nga ana e saj, me elementin subjektiv apo volitiv në kryerjen apo moskryerjen e veprimeve apo mosveprimeve, të cilat objektivist vijnë në kundërshtim me ligjin, parimet e përgjithshme të së drejtës apo me zakonet e mira. Elementi i fajësisë në kuptimin civil, me atë në kuptimin penal, ka disa ngjashmëri, por ka edhe disa veçori të caktuara. Edhe pse ligjvënësi, nuk ka parashikuar në asnjë dispozitë konkrete në Kodin Civil, përkufizimin e nocionit fajësi, gjykata çmon t'i referohet teorisë të së drejtës penale dhe dispozitave të Kodit Penal (nenet 14 dhe 15).

Në çështjen civile objekt gjykimi, veprimi i pretenduar prej palës paditëse, në ushtrimin e përmbushjes së rregullt të detyrës, si organ i administratës shtetërore prej palës së paditur, në këtë zgjidhje marrëdhënie pune, nuk përmban asnjë element të fajësisë të cilat objektivist të kishin për qëllim ardhjen e ndonjë pasoje kundrejt paditëses. Për sa më sipër, gjykata çmon se, kërkesëpadia e paraqitur nga pala paditëse, është e pabazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të rrëzohet.

### **3. Vlerësimi i çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.**

Gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7, gërma "ç", nenit 10, paragrafi 2, gërma "a" dhe nenit 44 të Ligjit Nr. 49/2012, kjo Gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

Në verifikimin e kushteve të pranueshmërisë së ankimit të paraqitur, konstatohet se vendimi nga gjykata e shkallës së parë është shpallur në datën 17.11.2016, ndërsa ankimi nga paditësja [REDAKTUAR] është paraqitur në datën 24.11.2016, pra, brenda afatit pesëmbëdhjetëditor, të përcaktuar në nenet 443, paragrafi i parë dhe 444, paragrafi i parë të Kodit të Proçedurës Civile. Po kështu, nuk rezulton të ekzistojnë kriteret penguese të parashikuara në nenin 45 të Ligjit Nr. 49/2012 që e bëjnë vendimin të paankimueshëm. Ankimi rezulton të jetë i plotë edhe në elementët e tjerë, si në elementët e formës edhe të përmbajtjes, lidhur me nënshkrimin nga pala që e ka paraqitur,

tregimin e palëve ndërgjyqëse, vendimin kundër të cilit është paraqitur ankimi, apo kërkimet për të cilat ai është paraqitur. Për të gjitha sa më sipër, Gjykata çmon se ankimi i paraqitur kundër vendimit nr. 1890, datë 17.11.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë objekt gjykimi, duhet të pranohet për shqyrtim.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor të zhvilluar në shkelje të rënda të rregullave procedurale lidhur me përbërjen e trupit gjykues, shkelje kjo që passjell pavlefshmërinë e vendimit dhe të procedurës së gjyqimit. Nga aktet e dosjes gjyqësore konstatohet se gjykimi i çështjes në shkallë të parë i është caktuar me short gjyqtarit Astrit Shema i cili edhe ka shpallur vendimin e ankimuar. Konstatohet se po i njëjti gjyqtar ka gjykuar edhe padinë e ngritur nga paditësja [REDAKTUAR] kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor Berat për zgjidhjen e konfliktit të punës me palën e paditur.

Në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, objekt shqyrtimi, konstatohet se janë marrë në analizë fakte e rrethana të njëjta me ato për të cilat Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka disponuar me vendimin nr. 464 datë 08.04.2014. Mbi të njëjtat arsye për të cilat gjykata e shkallës së parë ka konkluduar në lidhje me konstatimin e faktit se kontrata e punës së paditëses është zgjidhur për shkaqe të pajustificuara, paditësja [REDAKTUAR] pretendon konstatimin e faktit të diskriminimit dhe marrjen e dëmshpërblimit përkatës. Ky fakt pranohet edhe nga gjykata e shkallës së parë në vendimin objekt ankimi. Në këto rrethana është e dukshme se gjyqtari që ka gjykuar çështjen në shqyrtim është shprehur lidhur me faktet dhe rrethanat e parashtruara në të, duke gjykuar çështjen e mëparshme lidhur me zgjidhjen e mosmarrveshjes së punës me palën e paditur.

Në nenin 72 të K.Pr.Civ. për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i një çështjeje të caktuar, parashikohet shprehimisht se: “ Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur:

1. ka interes në çështje ose në një mosmarrveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim;



2. *ai vetë ose bashkëshortja e tij është e afërt deri në shkallë të katërt ose krushqji deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime hirësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përherëshme me njërën nga palët ose nga përfaqëuesit;*
3. *ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërën prej palëve ose njërin prej përfaqësuesve;*
4. *ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëres apo tjetrës palë.*
5. *është kujdestar, punëdhënës i njëres prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim.*
6. *në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.”*

Kurse neni 73 i Kodit të Proçedurës Civile parashikon se: *“Gjyqtari i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në gjykimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij. Kryetari i gjykatës kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër, me anë të shortit.”*

Në kushtet kur ekziston një prej kushteve të parashikuara nga pika 4 e nenit 72 të Kodit të Proçedurës Civile, gjyqtari që ka gjykuar çështjen në gjykatën e shkallës së parë kishte detyrimin të hiqte dorë nga gjykimi i çështjes. Kjo për faktin se shprehja e mendimit lidhur me çështjen në gjykim është shkak i arsyeshëm për të mos marrë pjesë në gjykimin e saj. Një qëndrim i tillë konstatohet të jetë mbajtur edhe nga Kryetari i Gjykatës Administrative të Apelit në vendimin nr. 614/1 prot. datë 15.11.2018 me të cilin është disponuar: *“Pranimi i kërkesës së gjyqtares Alkelina Gazidedja për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes administrative nr. 13212/7744 Regjistri Themeltar datë 16.03.2017. Zëvendësimi i relatorit të trupit gjykues me një gjyqtar tjetër të caktuar me short.”* Nga përmbajtja e këtij vendimi dhe e kërkesës së gjyqtares për heqje dorë nga gjykimi i çështjes konstatohet se gjyqtarja përkatëse është ndodhur në të njëjtat rrethana si edhe gjyqtari i shkallës së parë, pasi kjo gjyqtare ka marrë pjesë në përbërjen e trupit gjykues për shqyrtimin e ankimit të palës së paditur kundër vendimit nr. 464 datë 08.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Në vlerësim të fakteve e rrethanave si më sipër, Gjykata Administrative e Apelit konstaton se është cënuar parimi i paanshmërisë së gjykatës, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës. Siç analizon edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, ekzistojnë dy teste për të vlerësuar nëse një gjykatë është e paanshme: ai subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe testi objektiv me të cilin kuptohet *dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimet prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim*. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (shih vendimet nr.12, datë 13.04.2007; nr.21, datë 29.04.2010; nr.7, datë 07.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Nga pozita juridike e gjyqtarit, profesionalizmi i tij dhe “pjekuria morale”, si kushte themelore të paanshmërisë së tij, varet se si do të realizohet në praktikë pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës. Në këto rrethana, gjykata konstaton të jenë shkelur rëndë rregullat mbi përbërjen e rregullt të trupit gjykues, rregulla këto të parashikuara në dispozitat e cituara më sipër.

Sipas gërmës “ç” të nenit 50 të Ligjit Nr. 49/2012, Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në rastin kur shkeljet proceduriale janë të rënda dhe për të cilat ligji parashikon shprehimisht pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit. Kurse në nenin 54 gërma “b” të Ligjit Nr. 49/2012 është parashikuar se Gjykata Administrative e Apelit prish vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë dhe ia dërgon çështjen organit kompetent për rigjykim kur përbërja e trupit gjykues nuk ka qënë e rregullt.

Në rastin në gjykim Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka shkelur rregullat mbi përbërjen e trupit gjykues, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenet 72 e 73 të Kodit të Proçedurës Civile. Për pasojë, bazuar në nenin 50 gërma “ç” të Ligjit Nr. 49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative*”, kjo Gjykatë përfundimisht

vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë duhet prishur dhe çështja duhet dërguar për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 49 e 50, gërma “ç” të Ligjit Nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative”.

### **VENDOSI**

- Prishjen e vendimit nr. 1890, datë 17.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.
- Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

**Tiranë më 13.05.2019**

**ANËTAR**  
**Amarildo LAÇI**

dv

**ANËTAR**  
**Bari SHYTI**

dv

**KRYESUESE**  
**Lindita SINANAJ**

dv

**Vërtetohet njësia me origjinalin**

**KANCELAR**  
**LEONARD STRATAJ**

